

VENDIM
Nr.771, datë 24.9.2010

PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR.591, DATË 23.7.2010 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR DISIPLINIMIN E PËRDORIMIT TË FONDEVE BUXHETORE”,
TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr.9643, datë 21.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” dhe të ligjit nr.10 190, datë 26.11.2009 “Për buxhetin e vitit 2010”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në fund të shkronjës “dh” të pikës 1 të vendimit nr.591, datë 23.7.2010 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, të shtohet një paragraf, me këtë përmbajtje:

“Përfundimisht, lejohet Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, si autoritet kontraktor, për kryerjen e procedurave të prokurimit, me fondet e miratuara në buxhetin e vitit 2010, për blerjen dhe montimin e sistemit të pajisjeve për bllokimin e valëve të telefonisë së lëvizshme në institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale, si dhe për lidhjen e kontratës përkatëse.”.

2. Ngarkohen Ministria e Drejtësisë, Ministria e Financave dhe Agjencia e Prokurimit Publik për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha